

**BASHKIA E TIRANËS**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” shpk**

**Adresa: Tiranë, Njësia Nr. 8, Rruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 2, godinë Nr. 11-  
katëshe, Shkalla 2, kati 7.**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Asfaltim i rrugës “Shefqet Kuka”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Asfaltim i rrugës “Shefqet Kuka”.**  
**Fondi limit: 58,330,748.72** (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e dyzetë e tetë pikë shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me VKB Nr. 58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 30.05.2016, ora 12:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 18 datë 09.05.2016.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Junik” shpk & “Almo konstruksion” shpk**

NUIS J68007522L & NUIS J91915001P

Vlera e ofertës = **40,121,962.4** (dyzetë milion e njëqind e njëzetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë katër) lekë pa TVSH.

**2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kupa” shpk & “Kola Invest” shpk**

NUIS K51615512C & NUIS K93103401G

Vlera e ofertës = **40,183,456** (dyzetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Beladi” shpk**

NUIS K51501008J & NUIS J62903254C

Vlera e ofertës = **44,444,444** (dyzetë e katër milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Parllaku” shpk & “Hastoçi” shpk**

NUIS J61826145P & NUIS J62028009B

Vlera e ofertës = **45,913,142.08** (dyzetë e pesë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e dy pikë zero tetë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “B-93” shpk**

NUIS J62903508R

Vlera e ofertës = **49,597,563** (dyzetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Everest” shpk**

NUIS J61826145P & NUIS J78311921L

Vlera e ofertës = **49,801,511.35** (dyzetë e nëntë milion e tetëqind e një mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk**

NUIS K51518029B & NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = **51,205,153** (pesëdhjetë e një milion e dyqind e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” shpk**

NUIS L04803001U

Vlera e ofertës = **51,440,244.54** (pesëdhjetë e një milion e katërqind e dyzetë mijë e dyqind e dyzetë e katër pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Vllaznia” shpk & “Bami” shpk**

NUIS K11507003S & NUIS J94416206R

Vlera e ofertës = **51,930,745** (pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**10. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk**

NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **57,375,881** (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Junik” shpk & “Almo Konstruksion” shpk**

- Operatori ekonomik “Junik” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 11865 Prot. datë 07.04.2016 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 05.04.2016 pa përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2016. Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së

miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 06.05.2016 dhe zhvilluar më datë 30.05.2016.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “Junik” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, tëkonfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Junik” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Kapaciteti Teknik, pika 8 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pllakashtrues. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi, cka bie në kundërshtim Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 44 dhe Neni 46, pika 1 gërma ”b” ; si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b.
- Pas verifikimit të Shtojcës 9 të Bashkimit të Operatorëve ekonomik, KVO konstatoi se Autovincat e disponuar nga Shoqëria “Almo Konstruksion” shpk me targa AA 723 JD dhe TR 1275 M kanë aftësi mbajtëse secili 12 ton. Gjithashtu Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon Kamion me Vinc me targa AA278LR, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion shoqërues ashtu sic përcaktohet në DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 15 gërma “a”.Për sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk disponon Autovinc me aftësi mbajtëse 8 ton duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Almo Konstruksion” shpk & “Junik” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte (kapaciteti teknik) pika 15 për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## 2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kupa” shpk & “Kola Invest” shpk

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kupa” shpk & “Kola Invest” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve për objektin: “Asfaltim i rrugës “Shefqet Kuka” Ing. Z. Edmir Sula dhe Ing. Z. Jani Kola. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për Drejtuesit Teknik konstatoi se shoqëria “Kupa” shpk nuk ka paraqitur CV për Ing. Z. Edmir Sula cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 4.
- Operatori ekonomik “Kupa” shpk ka paraqitur si punë të ngjashme Kontratën me Nr. 2244 Prot. datë 19.12.2012 të lidhur me Autoritetin Kontraktor Komuna Petrelë me objekt “Ndërtim rruga Fshati i Ri, Mullet”, por nuk ka paraqitur certifikatën e marrjes në dorëzim të këtij objekti duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Kapaciteti Teknik, pika 2.
- Operatori ekonomik “Kupa” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Z. Petrit Gjorgji. KVO pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se shoqëria “Kupa” shpk nuk ka paraqitur CV duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 7.
- Gjithashtu KVO pasi verifikoi listpagesat e shoqërisë “Kupa” shpk konstatoi se mjeku i përgjithshëm Z. Petrit Gjorgji nuk figuron në listpagesat e kësaj shoqërie duke rënë në kundërshtim me dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 7 ku citohet: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë: - Mjek i përgjithshëm (1)”*.
- Operatori ekonomik “Kupa” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar punonjës të kualifikuar nga IQT cka bie në kundërshtim me dokumentat e tenderit, kapaciteti teknik, pika 8.
- Operatori ekonomik “Kola Invest” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar mjek të përgjithshëm duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, kapaciteti teknik, pika 7.
- Operatori ekonomik “Kola Invest” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pllakashtrues të kualifikuar nga IQT, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve), rezultoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kupa” shpk & “Kola Invest” shpk nuk ka paraqitur se disponon Makineri vijëzimi për bojë bicomponente cka bie në kundërshtim me Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të percaktuara në DST, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Referuar Shtojcës 9, Bashkimi i Operatoreve ekonomik ka deklaruar se disponon 30 copë Tabela paralajmëruese për sigurinë në rrugë. Për të verifikuar këtë fakt, ky Bashkim Operatorësh ka paraqitur Faturën Tatimore me Nr. 42 datë 23.03.2016. Pas verifikimeve u konstatua se Bashkimi i Operatorëve ekonomik disponon vetëm 20 copë Tabela paralajmëruese për sigurinë në rrugë cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku kërkohen 30 copë të tilla.
- Gjithashtu referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve), rezultoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kupa” shpk & “Kola Invest” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon Sinjalistikë rrugore semaforë me bateri

(minimumi 2 copë) cka bie në kundërshtim me Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të percaktuara në DST, Kapaciteti Teknik, pika 15.

### 3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Beladi” shpk

- Operatori ekonomik “Beladi” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar punonjës të kualifikuar nga IQT duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, kapaciteti teknik, pika 8.
- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponimin e makinerive) të Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Beladi” shpk rezulton se Shoqëria “Sireta 2F” ka deklaruar se disponon Minifadromë modeli Bobkat 980. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruar për mjetin e deklaruar sipërcitua, konstatoi se referuar Faturës Tatimore me Nr. 252 datë 23.05.2011 si dhe aktit të cdoganimit rezulton të jetë minieskavator cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 15.
- Referuar DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 15 ndër të tjera përcaktohet se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e punës si më poshtë:*
  - Kokore minimumi 30 copë
  - *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5 – 7 litra secila minimumi 3 copë*
  - Prozhektorë ndricimi për natën minimumi 4 copë
  - *Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë*
  - *Tabela paralajmëruese për sigurinë në rrugë minimumi 30 copë*
  - *Sinjalistike rrugore semaforë me bateri minimumi 2 copë*”.
- KVO konstatoi se referuar Shtojcës 9 si dhe Faturës Tatimore me Nr. 4264 datë 10.03.2016 të paraqitur nga Shoqëria “Sireta 2F” shpk rezulton se kjo shoqëri disponon 10 kokore si dhe 2 prozhektorë ndricimi për natën dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër që të provojë të kundërtën. Në këtë mënyrë Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku kërkohen minimumi 30 copë kokore si dhe minimum 4 copë prozhektorë ndricimi për natën.
- Gjithashtu pas verifikimit të Shtojcës 9 të Bashkimit të Operatorëve ekonomik, KVO konstatoi se Autovinci i disponuar nga Shoqëria “Sireta 2F” shpk me targa AA 798 CP ka aftësi mbajtëse 6.6 ton, Autovinci i disponuar nga Shoqëria “Beladi” shpk me targa AA306 KZ ka aftësi mbajtëse 2.2 ton, ndërsa kamioni vinc me targa EL 8584 B ka aftësi mbajtëse 5.2 ton. Për sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk disponon Autovinc me aftësi mbajtëse 8 ton duke mosplotësuar Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Beladi” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte (kapaciteti teknik) pika 15 për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqëruar për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

#### 4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Parllaku” shpk & “Hastoçi” shpk

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Hastoçi” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Kapaciteti Teknik, pika 8 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pllakashtrues. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik persa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi, cka bie në kundërshtim Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 44 dhe Neni 46, pika 1 gërma ”b” ; si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b.
- Bashkimi i operatorëve ekonomik Parllaku shpk & Hastoçi shpk lidhur me kërkesën e pikës 15, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)” ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës nr.9 dhe dokumentacionin përkatës nga përllogaritjet e së cilave rezulton se ky bashkim nuk plotëson tonazhin e kërkuar. Konkretisht kerkohen “Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtës minimumi 20 ton), 4 copë, *Pronësi ose me qera*”. Nga mjetet kamionë të deklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik Parllaku shpk & Hastoçi shpk vetëm kamioni me targë TR0940T, plotëson tonazhin e kërkuar ndërsa kamionët e tjerë nuk plotësojnë tonazhin e kërkuar më lart.

#### 5. Operatori ekonomik “B-93” shpk

- Operatori ekonomik “B-93” shpk referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) ka deklaruar se disponon minieskavator Tipi Volvo RC 58 R. KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e deklaruar konstatoi se është paraqitur vetëm Vërtetim Zhdoganimi ku sipas të cilit rezulton se minieskavatori ka kapacitet 5.5 ton, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera është kërkuar që: *“Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të disponojnë minieskavator 3-5 ton (1 copë)”. Gjithashtu Shoqëria nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër që të provojë disponueshmërinë e mjetit.*

- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponimin e makinerive) të Operatorit ekonomik “B-93” shpk rezulton se Shoqëria ka deklaruar se disponon Minifadromë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin e deklaruar të sipërcituar, konstatoi se referuar aktit të cdoganimit rezulton të jetë minieskavator cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 15.

Sa më sipër Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte (kapaciteti teknik) pika 15 për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

- Gjithashtu Operatori ekonomik “B-93” shpk ka paraqitur Shtojcën 9, Deklarat mbi disponueshmerine e mjeteve. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk ka deklaruar vendodhjen e saktë të mjeteve të deklaruara sipas Shtojcës 9 cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 15 gërma “f”.

## 6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Everest” shpk

- Shoqëria “Kacdedja” shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe ne list pagesat per periudhen Janar 2015 – Mars 2016, rezulton te kete nje numer mesatar prej **45 punonjesish**. Referuar Kontratës per Bashkimin e Perkohshem te shoqerive me Nr. 1308 Rep, Nr. 848 Kol. të lidhur me date 28.05.2016 midis shoqërisë Kacdedja shpk dhe Everest shpk ku shoqërite kane rene dakort qe perqindja e pjesmarrjes ne sherbim te jete si me poshte:

**Kacdedja shpk – 61 %**

**Everest shpk – 39 %**

- Ndërkohë shoqëria Kacdedja shpk eshte shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: **“Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjecare “1 Maj”** ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë **50 punonjes**. Shoqëria Kacdedja shpk ne baze te Marreveshjes se Bashkpunimit te lidhur me shoqerine Aluera shpk rezulton se **37** punonjes te kesaj shoqerie janë te angazhuar per realizimin e objektit sipas kontrates te lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tirane me Nr. 1858/10 Prot. datë 27.10.2015, punime të cilat ende nuk kanë përfunduar. Pra ne diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e kontrates se lartpermendur, shoqërisë i ngelen vetëm **8** punonjës. Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit **“Asfaltim i rrugës Shefqet Kuka”** eshte **70** punonjes. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 3, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:

○ *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

○ *b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....*

- Gjithashtu Shoqëria “Kacdedja” shpk për të vërtetuar përvojën e sukseshme ka paraqitur kontrata pune të ngjashme si më poshtë:

○ 1-“Ndertim i rruges lidhese midis rruges Elez Isufi dhe Ali Gjuzi” e lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë ku shoqëria Kacdedja shpk ka qënë në bashkëpunim me shoqërinë Agri Konstruktion shpk. Vlera e kontrates është 18,526,011 lekë pa TVSH. Shoqëria Kacdedja shpk në bazë të përqindjes së partneritetit (64 %) i takon vlera e realizimit të kontratës në masën 11,856,647 lekë pa TVSH.



- 2-“Ndertim i rruges Bajram Allaraj” e lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë ku shoqëria Kacdedja shpk ka qenë në bashkëpunim me shoqërinë Agri Konstruksion shpk.Vlera e kontrates është 17,894,963 lekë pa TVSH.Shoqëria Kacdedja shpk në bazë të përqindjes së partneritetit (63 %) i takon vlera e realizimit të kontratës në masën 11,273,826 lekë pa TVSH.
- 3-“Ndertim Rruga Derjan Gjorice Bushtrice Zanave Drini” e lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Kamez ku vlera e kontrates është 16,262,454 lekë pa TVSH dhe me vlere të kontrates shtesë 3,170,954 lekë pa TVSH.
- Sa më sipër konkludohet se Shoqëria “Kacdedja” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e sukseshme nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën 29,165,374 lekë pa TVSH si edhe pikën 1/b ku shumatorja e të gjitha kontratave të ngjashme ne raport me përqindjen e pjesmarrjes ne bashkim duhet te jete ne vleren 71,163,513 lekë pa TVSH.
- Në këtë mënyrë shoqëria “Kacdedja” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 6 si dhe Kreu VIII, Neni 74, pika 3.
- Shoqëria ‘Everest’ shpk ka paraqitur Certificate OHSAS 18001:2007 me afat vlefshmërie deri me date 20.05.2016.Duke qene se afati i fundit per dorezimin e ofertave per proceduren e prokurimit me objekt: “Asfaltim i rruges Shefqet Kuka” ka qene data 30.05.2016, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konkludoi se kjo certificate eshte e pavlefshme, pasi ka skaduar afati i vlefshmerise se saj.Per sa me lart Shoqëria ‘Everest’ shpk nuk ploteson Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te vendosura ne DST, Kapaciteti Teknik, pika 11.

## 7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk

- Shoqëria “Arifaj” shpk ka deklaruar si drejtues teknik te shoqërisë Ing. Znj. Lavdie Mici te cilen me ane te deklarates per drejtuesin teknik e ka caktuar tashme drejtues teknik ne objektin ne te cilin eshte kualifikuar ne vend te pare nga Bashkia Tirane “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollesha” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajës” me kufirin e Njesisë Bashkiake Nr. 10” dhe per te cilen ka deklaruar se nuk do te jete i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete gjate gjithë kohes ne objekt duke mos plotesuar kështu Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 4, pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.
- Shoqëria ”Arifaj” shpk ka paraqitur se disponon sipas shtojcës 9 Autobetoniere me targa “TR 1176 M”.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se mjeti i deklaruar si më sipër është i angazhuar në objektin: “*Muhamet Gjollesha*” – “*Myslym Shyri*” – “*Rruga e Kavajës*” me kufirin e Njesisë Bashkiake Nr. 10” ne te cilin shoqëria është shpallur fituese nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane dhe për të cilën shoqëria “Arifaj” shpk ka paraqitur deklaratën e mosangazhimit të këtij mjeti në kontrata të tjera të lidhura me Bashkinë Tiranë, duke rënë në kundërshtim me Kap 2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, kapaciteti teknik, pika 15, gërma (f).
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis 05” shpk & “Arifaj” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte (kapaciteti teknik) pika 15 për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643

datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis 05” shpk & “Arifaj” shpk, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

## 8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Vllaznia” shpk & “Bami” shpk

- Shoqëria Bami shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe ne list pagesat per periudhen Janar 2015 – Mars 2016, rezulton te kete nje numer mesatar prej **85 punonjesish**. Referuar Akt-Marreveshjes per Bashkëpunim të Perkohshem me Nr. 1951 Rep, Nr. 3720 Kol. të lidhur me date 27.05.2016 midis shoqërisë Bami shpk dhe Vllaznia shpk ku shoqërite kane rene dakort qe perqindja e pjesmarrjes ne sherbim te jete si me poshte:

**Bami shpk – 63 %**

**Vllaznia shpk – 37 %**

- Ne baze te Marreveshjes se Bashkëpunimit si dhe referuar VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 74, pika 3 ku citohet se: *‘Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.’*, rezulton se Operatori ekonomik Bami shpk duhet te kete nje numer mesatar prej **44** punonjësish per realizimin e kontrates me sukses. Ndërkohë që shoqëria është shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i rrugës ”A. Shefqeti”** ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë **60 punonjes** te cilet janë të angazhuar per realizimin e ketij objekti, punime të cilat ende nuk kanë përfunduar. Pra ne diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e kontratës, shoqërisë i ngelen vetëm **25** punonjës. Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit **“Asfaltim i rrugës “Shefqet Kuka”** është **70** punonjes. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 3, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*  
*b) Aftësia teknike ; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....*

## 9. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

- Shoqëria “BE-IS” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve në objekt Ing. Z. Abdullah Dushi; Ing. Z. Hamz Islamaj dhe Ing. Znj. Fjoralda Hysi.KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për drejtuesit teknik të deklaruar nga kjo shoqëri, konstatoi se Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, pasi nuk janë paraqitur Librezat përkatëse të punës për Drejtuesit teknik të mësipërm.
- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk ka paraqitur diplomë për mjekun e përgjithshëm duke rënë në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 7.
- Gjithashtu Shoqëria BE-IS shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe ne list pagesat e paraqitura per periudhen Janar 2015 – Mars 2016, ,rezulton te kete nje numer mesatar prej **86 punonjesish**.

Ndërkohë shoqëria BE-IS është shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i trotuareve dhe rruges Ali Demi”** ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë **70 punonjes**. Shoqëria BE-IS shpk ne baze te Marreveshjes se Bashkpunimit te lidhur me shoqerine Piervis shpk rezulton se **49 punonjes** te kesaj shoqerie janë të angazhuar per realizimin e objektit sipas kontrates te lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tirane me Nr. 7279/10 Prot. datë 09.09.2015, punime të cilat ende nuk kanë përfunduar. Pra ne diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e kontrates se lartpermendur, shoqërisë i ngelen vetëm **37 punonjes**. Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit **“Asfaltim i rrugës “Shefqet Kuka”** është **70 punonjes**. Në këtë mënyrë shoqëria nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 4, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) ku përcaktohet se:

*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

*b)Aftësia teknike ;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.....*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” shpk**, me adresë: **Njësia Nr. 8, Ruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 20, godinë, Nr. 11-katëshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **51,440,244.54** (pesëdhjetë e një milion e katërqind e dyzetë mijë e dyqind e dyzetë e katër pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:** 14.06.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.